



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË  
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 7  
07.03.2014

NR. VENDIMI 3  
10.03.2014

**V E N D I M**

**«Për Sekuestrim Pasurie»**

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë e përbërë prej

**GJYQTARE: Liljana BAKU**

Asistuar nga sekretare seance **Alma RAMAJ**, sot në datë 10.03.2014, ora 12.00, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën penale Nr.7 Regj. me:

**KËRKUESE:** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar nga **prokurori Edvin KONDILI**.

**KUNDËR:**

**SHTETASVE NËN HETIM:** **S.G.**, i biri i M. dhe i Sh., i datëlindjes xxx, lindur dhe banues në xxx, xxx.

**M.G.**, i biri i S. dhe i F., i datëlindjes xxx, lindur dhe banues në xxx, xxx.

**R.G.**, i biri i S. dhe i F., i datëlindjes xxx, lindur dhe banues në xxx, xxx.

**OBJEKTI:**

**I.** Sekuestrimi i shumës monetare, të shtetasve M.G., S.G. dhe R.G., të përbërë:

**1.** Prej **xxx (xxx) euro**, që ndodhen në Bankën xxx, në llogarinë e shtetas R.R., e datëlindjes xxx.

2. Prej **xxx (xxx) euro**, në emër të M.G., në llogarinë me numër xxx, në Bankën xxx.

3. Prej **xxx (xxx) euro**, në emër të shtetasve R. dhe S.G., në llogarinë me numër xxx, në Bankën xxx.

**II.** Për administrimin e kësaj pasurie të ngarkohet Z. K.Xh., i cili është administrator pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave Tiranë. Për ekzekutimin e kësaj sekuestroje të ngarkohet Zyra e Përmbarimit Gjyqësor xxx.

**BAZA LIGJORE:**

Ligji Nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Në përfundim të gjykimit gjykata, pasi e gjeti veten kompetente për të gjykuar dhe vendosur mbi kërkesën e paraqitur, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, pasi dëgjoi pretendimin përfundimtar të prokurorit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit të saj

**V Ë R E N**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në datë xxx, regjistroi procedimin pasuror Nr.xx, Viti xxx, në ngarkim të shtetasve nën hetim M.G., S.G. dhe R.G., si persona të dyshuar për kryerje të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Procedimi pasuror ishte rrjedhojë e procedimit penal Nr.xx, Viti xxx, të rregjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx.

Nga materiali hetimor, që Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx i dërgoi Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, rezultoi sa më poshtë:

Shtetasi M.G. në datë xxx depozitoi në Bankën xxx, në llogarinë rrjedhëse me Nr. xxx, shumën prej xxx (xxx) euro, në datë xxx shumën prej xxx (xxx) euro,

në datë xxx shumën prej xxx (xxx) euro, të deklaruara prej tij si përfitime nga emigracioni dhe, po në datë xxx shumën prej xxx (xxx) euro të deklaruar si shumë e marrë hua nga shtetasi V.B.

Shtetasit R.G. dhe S.G., në datë xxx çelën në Bankën xxx llogarinë bankare me Nr. xxx duke depozituar në të shumën prej xxx (xxx) dhe deklaruar si burim të saj emigracionin.

Në datë xxx, shtetasi M.G. transferoi shumën monetare prej (xxx xxx) euro, nga llogaria e tij në llogarinë bankare të shtetases R.R., me profesion notere (anëtare e Dhomës së Noterisë xxx, në funksion të përmbylljes së kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme të lidhur prej tij me palë shitëse shtetasin J.S. Aktualisht shuma monetare, prej xxx euro, ndodhet në Bankën xxx, në llogarinë e shtetases R.R.

Gjithashtu pranë Bankës xxx, u konstatuan edhe një shumë prej xxx (xxx) euro në emër të M.G., në llogarinë me numër xxx dhe, një shumë prej xxx (xxx) euro në emër të shtetasve R. dhe S.G., në llogarinë me numër xxx (e cila, siç do të rezultojë më poshtë, mbeti pas transferimit prej shumës xxx euro të shumës prej xxx euro, në funksion të plotësimit të shumës prej xxx euro).

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, pasi ngriti dyshimin e arsyeshëm, të bazuar në prova (sipas saj) se, transaksioni financiar i sipërcituar, në funksion të kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, me palë shitëse shtetasin J.S., kryhej në funksion të pastrimit të produkteve të rrjedhura nga veprimtari e kundraligjshme, e parashikuar si vepër penale në nenin 287 të Kodit Penal, vendosi masën e sekuestros preventive mbi llogaritë bankare me shumën përkatëse të përshkruara më sipër, në funksion të procedimit penal me Nr. xx Viti xxx.

Gjithashtu, pasi çmoi se ndodhej para rasteve të parashikuara nga Ligji Nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, materialin hetimor i’a kaloi Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Në datë xxx, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë paraqiti para kësaj Gjykate, kërkesën me objekt sekuestrimin e llogarive bankare, të përshkruara më sipër, duke patur si bazë ligjore Ligjin Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata, në respektim të kërkesave të nenit 12 pika 1 të Ligjit në fjalë, brenda afatit ligjor pesëditor, të parashikuar në këtë dispozitë, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën e paraqitur.

Në kërkesë dhe në seancë gjyqësore prokurori pretendoi:

**1.** Derdhja e shumave të konsiderueshme në euro, në llogari bankare, brenda një periudhë kohe shumë të shkurtër, duke deklaruar si burim të krijimit të tyre emigracionin, shërben si bazë për ngritjen e dyshimit të arsyeshëm, të bazuar në prova, për kryerjen nga shtetasit M.G., S.G. dhe R.G., të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Duke qënë shtetasit M.G., S.G. dhe R.G., të dyshuar për kryerjen e një vepre të tillë, në bazë të nenit 3 pika 1 gërma “d” të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, janë subjekt i zbatimit të tij dhe pasuria e tyre mund t’i nënshtrohet masës së sekuestros.

**2.** Vendosja e masës së sekuestros, mbi llogaritë bankare, pavarësisht se mbi to është vendosur masa e sekuestros preventive, sipas prokurorit, është e domosdoshme pasi ekziston rreziku real dhe potencial që pasuria e luajtshme, në formën e shuma monetareve, të tjetërsohet apo të humbasë (neni 11/1, pikat “a” dhe “b”), në rast të shfuqizimit të sekuestros së vendosur në funksion të procedimit penal. Në këto kushte, sipas tij, diktohej nevoja e ruajtjes së këtyre llogarive nga mbyllja e tyre, parashikuar si kriter në nenin 11 pika 1 gërma “a” e Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009.

**3.** Bazuar në nenin 5 pika 3 e Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009, duhet të urdhërohet pezullimi i zbatimit të masës së sekuestros, pezullim i cili duhet të përfundojë me dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokimin apo shuarjen e kësaj mase.

Në funksion të provueshmërisë së pretendimeve dhe kërkesës në gjykim, prokurori paraqiti si provë aktet që kishin të bënin me regjistrimin e procedimit penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, përfshirë edhe vendimin e saj për vendosjen e sekuestros mbi llogarinë bankare në shumën prej xxx euro dhe të çdo llogarie tjetër që i përkiste shtetasve S., M. dhe R.G.; dokumentet bankare ku dokumentohej çelja e llogarive dhe transaksionet e kryera me to; të dhënat e marra nga bankat e nivelit të dytë dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në rrethe, në lidhje me depozita apo pasuri të paluajtshme në emër të shtetasve M.G., S.G. dhe R.G. (me rezultate negative) si dhe, deklaratimet e tyre me cilësinë e personave nën hetim.

Sipas deklarimeve të shtetasit M.G., dhënë në datë xxx shuma prej xxx euro, depozituar në Bankën xxx, Dega xxx, nuk i përkiste plotësisht atij. Nga kjo shumë, xxx euro ishte e ardhur e tij nga emigracioni, xxx euro i përkiste babait të tij S. dhe vëllait R., gjithashtu e ardhur nga emigracioni, ndërsa xxx euro shumë e marrë borxh prej tij, nga shtetasi V.B. (i cili ka një firmë ndërtimi në xxx) sipas Kontratës së Huasë Nr. xxx Rep, Nr. xx Kol datë xxx. Depozitimi i shumës prej xxx euro në llogarinë bankare të shtetases R.R. u bë në funksion të Kontratës së Shit-Blerjes, me kusht, me Nr. xxx Rep, Nr. xxx Kol datë xxx për blerjen e objektit “xxx” në pronësi të shtetasit J.S.i. Ky i fundit e nxori në shitje objektin për shkak të mospagimit të kredisë së marrë prej tij në bankë.

Të njëjtin deklaram bënë edhe shtetasit S.G. dhe R.G. në datë xxx.

Gjykata në analizë të pretendimeve të prokurorit dhe provave të paraqitura prej tij, çmon se kërkesa është e drejtë, e bazuar ligj dhe prova dhe si e tillë duhet të pranohet për këto arsye:

I.Kërkesa u paraqit në zbatim të nenit 3 të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të titulluar “Fusha e zbatimit”.

**Sipas pikës 1 të këtij neni, ligji gjen zbatim për pasuritë e personave mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicje, për kryerjen prej tyre të një sërë veprash penale në të cilat përfshihet edhe vepra penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal (gërma “d” e kësaj pike).**

U provua në gjykim se shtetasit M.G., S.G. dhe R.G. janë persona nën hetim për kryerje të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprave penale”, për të cilën është duke proceduar Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx.

Çelja e llogarive bankare në emër të tyre, në shuma të konsiderueshme eurosh dhe brenda një kohe shumë të shkurtër; Deklarimi, prej tyre, i shumave të depozituara si të ardhura nga emigracioni; Mungesa e ndonjë aktiviteti tregëtar, të regjistruar në emër të tyre apo familjarëve; Mungesa e pasurive të palujtëshme nga të cilat të mund të gjenerohen të ardhura; Mungesa e deklaramit për para kesh në momentin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe mungesa e dërgesave të parave nëpërmjet unioneve të licensuar për këtë qëllim; çmohen nga gjykata si indicje të rëndësishme mbi bazën e të cilave ngrihet dyshimi për kryerje, nga shtetasit M.G., S.G. dhe R.G., të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit

Penal, vepër kjo e përfshirë në rrethin e veprave penale për të cilat bën fjalë pika 1 e ligjit.

**II.** Në interpretim dhe zbatim të nenit 11 të ligjit, gjykata çmon se për vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë është e domosdoshme ekzistenca njëkohësisht e dy kritereve të përgjithshme që kanë të bëjnë me: **1.** Ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në indicje që tregojnë se personat mund të jenë të përfshirë në veprimtari kriminale. **2.** Zotërimin e pasurive dhe të ardhurave që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre, si dhe

Ekzistenca e të paktën njërit prej kritereve të veçanta, të parashikuara në pikat “a” dhe “b” të këtij neni.

Përsa më sipër, u arsyetua se mbi shtetasit M.G., S.G. dhe R.G. rëndon dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në indicje, për përfshirje të tyre në veprimtarinë kriminale të pastrimit të parave, (për të cilën janë duke u hetuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor xxx), që mund të jenë produkte të një veprimtarie të jashtëligjshme.

Shtetasit M.G., S.G., R.G. dhe familjarët e tyre nuk kanë të rregjistruar asnjë aktivitet tregtar dhe asnjë të ardhur tjetër të ligjshme që të mund të justifikojë shumat e mëdha të eurove, të derdhura në llogari bankare (kriteri 2 i përgjithshëm).

Ekziston rreziku real për tjetërsimin e llogarive bankare. Duke qënë se masa e sekuestros preventive është e kushtëzuar nga ecuria e procedimit penal, në rast pushimi të tij është e natyrshme që shtetasit M.G., S.G. dhe R.G. të bëjnë të gjitha përpjekjet për t’i mbyllur ato me qëllim shmangien nga një konfiskim i mundshëm (kriteri i veçantë i parashikuar në gjermën “a” të pikës 1 të nenit 11). Ky rrezik bëhet edhe më evident pasi shtetasit nën hetim të njoftohen edhe për procedimin pasuror të nisur ndaj tyre dhe për masën e sekuestros të vendosur nga kjo gjykatë.

Ndodhur para faktit të ekzistencës së masës së sekuestros preventive, bazuar në nenin 5 pika 3 e Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, gjykata gjen të bazuar kërkesën e prokurorit për pezullimin e pasojave të zbatimit të masës së sekuestros deri në dhënien e një vendimi gjyqësor për revokimin apo shuarjen e saj (sekuestros preventive).

Në bazë të pikës 2 të nenit 14 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, pasi gjykata vlerësoi praninë e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta për vendosjen e masës së sekuestros, çmon se ekziston detyrimi që të njoftojë zotëruesit e

pasurive të sekuestruara për vendimin e marrë prej saj. Në zbatim të kësaj dispozite, për realizimin e njoftimit zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 130, 131, 132 dhe 133 të Kodit të Proçedurës Civile. Duke qënë se gjykata e gjeti kërkesën e paraqitur të drejtë dhe ligjore, vendimi i saj duhet t'i njoftohet shtetasve nën hetim M.G., S.G. dhe R.G.

Në bazë të pikës 3 të nenit 14 dhe pikës 1 të nenit 15 të Ligjit në fjalë, kompetente për ekzekutimin e vendimit të sekuestrimit të pasurive janë përmbaruesit gjyqësorë dhe për administrimin e tyre administratorët e Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Në këto kushte, është detyrim ligjor për gjykatën që në vendimin e saj të urdhërojë zyrën e përmbarimit, në juridiksionin e të cilës ndodhet pasuria e luajtshme (neni 516 i Kodit të Proçedurës Civile) dhe, një administrator të agjensisë, të cilët do të koordinojnë punën për zbatimin e vendimit të sekuestros.

## **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata, në bazë të nenit 3 pika 1 gërma “d”, nenit 5 pika 3, nenit 7 pika 1 dhe 2, nenit 11 pika 1 gërma “a”, nenit 12 pika 1 dhe 2, nenit 14 pika 2 dhe 3, nenit 15 pika 1 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

## **V E N D O S**

Pranimin e kërkesës.

Vendosjen e masës së sekuestros mbi shumat monetare të shtetasve M.G., S.G. dhe R.G., të përbërë prej:

- 1. Shumës xxx (xxx) mijë euro**, që ndodhen në bankën xxx, në llogarinë e shtetasës R.R., e datëlindjes xxx.
- 2. Shumës xxx (xxx) euro**, në emër të M.G., në llogarinë me numër xxx, në bankën xxx.
- 3. Shumës xxx (xxx) euro**, në emër të shtetasve R.G. dhe S.G., në llogarinë me numër xxx, në bankën xxx.

Pezullimin e pasojave të zbatimit të masës së sekuestros deri në dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokim apo shuarje të masës së sekuestros preventive.

Për ekzekutimin e vendimit të sekuestros ngarkohet Zyra e Përmbarimit Gjyqësor

në xxx dhe, për administrimin e pasurisë së sekuestruar, administratori K.Xh., në Agjensinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

Urdhërohet K/Sekretaria, pranë kësaj Gjykate, t'u njoftojë shtetasve M.G., S.G. dhe R.G. vendimin e sekuestrimit.

Kundër vendimit lejohet e drejta e ankimit të veçantë, brenda afatit ligjor, në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

**U shpall sot në Tiranë, në datë 10.03.2014.**

**SEKRETARE**

**Alma RAMAJ**

**GJYQTARE**

**Liljana BAKU**